

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Filologjisë



MA PRANVERA OSMANI

# **FJALITË KALLËZUESORE NË GJUHËN SHQIPE**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori:

Prof. dr. Naser Pajaziti

Prishtinë

2024

University of Prishtina “Hasan Prishtina”

Faculty of Philology



MA PRANVERA OSMANI

# **PREDICATIVE CLAUSES IN ALBANIAN LANGUAGE**

DOCTORAL THESIS

Mentor:

Prof. dr. Naser Pajaziti

Prishtinë

2024

## Rezyme

Struktura e punimit të disertacionit tonë “Fjalitë kallëzuesore në gjuhën shqipe” përbëhet nga shtatët krerë. Ky punim kërkimor-shkencor është i ndarë në kapituj dhe nënkaptuj.

Në kreun e parë kemi paraqitur konceptet e disa njësive sintaksore, si: sintagmë, fjali, fjali e përbërë me bashkërenditje, fjali e përbërë me nënrenditje. Për ndërtimin e një sintagme shërbejnë një ose më shumë fjalë, të cilat lidhen me njëra-tjetrën në bazë të rregullave të përcaktuara qartë. Për të përcaktuar nëse një vijimsi fjalësh formon një sintagmë, ka disa prova. Prania e përbërësve mund të provohet duke zbatuar kriteret për dallimin e përbërësve, siç janë: testi i zëvendësimit, testi i zhvendosjes ose i lëvizjes, testi i bashkërenditjes, testi i fragmentit.

Kreu i dytë vijon me trajtimin e disa çështjeve që lidhen me kriteret e klasifikimit të fjalive me nënrenditje. Për klasifikimin e kësaj njësie në gjuhën shqipe, kemi marrë gramatikat tradicionale të shqipes në formë kronologjike, duke filluar nga ajo më e hershme e gjer te gramatikat e sotme të shqipes, trajtimet e bëra në studimet e tyre së fundmi nga studiuesit shqiptarë, të cilët kanë një qasje më ndryshe sa i përket kriterëve të klasifikimit të fjalive të varura në gjuhën shqipe.

Në kreun e tretë kemi trajtuar klasifikimin e foljeve sipas funksionit dhe kuptimit, gjejjësisht duke u ndalur te klasifikimi tradicional i foljeve, pastaj është trajtuar edhe çështja e transivititetit dhe ergativitetit të foljet e shqipes. Në këtë punim jemi marrë gjerësisht me trajtimin e valencës, strukturën argumentore të foljes dhe rolet tematike që mund t’i kenë argumentet në një fjali.

Në kreun e katërt kemi trajtuar foljet këpujore dhe fjalitë këpujore në gjuhën shqipe. Përgjithësisht, klasifikimi i tyre bëhet në bazë të kuptimit leksikor dhe për analizimin e tyre në mënyrë kronologjike kemi marrë gramatikat e shqipes në tërësi. Studiuesit që janë marrë me shqyrtimin dhe analizën e fjalive këpujore janë: F.R. Higgins (1973), L. Heggie (1988), L. Mikkelsen (2005), C. Heycock (1997), M. Haliday, A. Moro (1997), R. Huddleston (2002), B. Rusell, S. Rothstein (1995) etj.

Ndër të parët studiues që është marrë më çështjen e klasifikimit të fjalive këpujore është Higgins-i, i cili i analizon fjalitë këpujore sipas një taksonomie të quajtur si *taksonomia e fjalive*

*këpujore*. Fjalitë këpujore klasifikohen në fjali predikative, fjali specifikuere dhe fjali identifikuese. Te fjalitë këpujore veprojnë një varg rregullash transformuese, të cilat më pas e bëjnë të mundur kalimin e fjalisë nga struktura sipërfaqësore në strukturën e thellë. Rrjedhimisht, të gjithë tipat e këtyre fjalive janë struktura sipërfaqësore dhe kanë vetëm se një strukturë të thellë. Gjatë procesit të ndryshimit të pozicioneve të përbërësve në fjali, përftohen fjali gramatikisht korrekte, si më poshtë:

(a) *Teuta është mjeke*. (fjali predikative)

(b) *Mjeke është Teuta*. (fjali specifikuere)

Te shembulli (a) që është fjali predikative, plotësi predikativ shprehet me një emër në numrin njëjës, i cili mund zhvendoset në pozicionin e kryefjalës [Spec] të lloji tjetër i fjalisë, fjalia specifikuere. Në këtë lloj klasifikimi është i rëndësishëm koncepti i referencialitetit, i cili ka të bëjë me lidhjen midis objektit a personit dhe sinatagmës a fjalisë që i referohemi.

Dhe në fund, pas shqyrtimit dhe analizimit të fjalive këpujore në gjuhën shqipe jepet frekuenca e përdorimit të tyre në korpusin tonë të zgjedhur.

Në kreun e pestë kemi trajtuar disa çështje teorike të trajtimit të kallëzuesit emëror dhe kallëzuesorit. Në qasjet teorike bashkëkohore, kallëzuesi i ashtuquajtur si kallëzues emëror në traditën tonë është analizuar brenda fjalisë përmes relacionit subjekt-folje këpujore-kallëzuesor, duke ndërtuar kështu një fjali këpujore. Ka studiues që e njohin ndërtimin e të ashtuquajturit kallëzues emëror, ndërsa disa të tjerë mendojnë se elementi pas këpujës formon një kategori të veçantë gramatikore, formon plotësin predikativ. Në këtë punim kemi dhënë një këndvështrim tjetër për gjymtyrët e fjalisë të gramatikës tradicionale dhe do të flitet për një tip të ri fjalish: *fjalitë e vogla (FjV)*.

Studimi ynë ka për qëllim trajtimin e kallëzuesit emëror dhe përcaktorit kallëzuesor si dy entitete me tipare të njëjta kuptimore dhe strukturore në një kategori të vetme sintaksore, një kategori e tillë sintaksore s'mund të merret më si një gjymtyrë tradicionale e fjalisë, por si një tip i veçantë fjalish, konkretisht si *fjali e vogël*. Duhet theksuar se jo të gjithë kallëzuesit emërorë mund të përfshihen në këtë kategori sintaksore. Vërehet se nuk ka dallime midis një përcaktori kallëzuesor të kryefjalës dhe pjesës më të madhe të tipave të kallëzuesve emërorë, por ekzistojnë dallime strukturore ndërmjet këtyre dy kategorive dhe përcaktorit kallëzuesor të kundrinës. Po ashtu duhet

pohuar që dallimet midis tyre nuk janë aq të mëdha sa të përlligjin ndarjen e tyre në kategori të veçanta.

Në gjuhën shqipe kategoria e kallëzuesorit përbën dy tipa të fjalive të vogla:

- 1) Përcaktorët kallëzuesorë të kundrinës: fjali të vogla si komplemente të foljes
- 2) Përcaktorët kallëzuesorë të kryefjalës dhe kallëzuesit emërorë: fjali të vogla me folje ngritëse.

FjV që realizohen si komplemente të foljes gjenden në ndërtime të tipit: ***E gjeta [FjV derën të hapur]***. Përbërësit ***derën të hapur*** formojnë një strukturë predikative minimale, pra, një fjali të vogël, me strukturë kryefjalë-predikat, ku kryefjala është në rasën kallëzore dhe predikati shprehet me një mbiemër.

Sipas kësaj analize, të gjithë përcaktorët kallëzuesorë të kundrinës në gjuhën shqipe mund të shihen si predikatë të FjV që janë komplement i foljes.

Ose fjalia ***E pashë [Petritin të lodhur]*** sipas studiuses L. Buxheli përbërësi në kllapa është fjali e vogël.

Ose një shembull tjetër që është FjV, por ne mendojmë se kjo nuk është një fjali e tillë, si:

***E pashë Petritin [të shkruante [i lodhur]]***. (Buxheli, 2007:91)

Mendojmë se kjo fjali ka një predikat foljor të eptueshëm dhe si e tillë s'mund të hyjë në grupin e fjalive të vogla ngase tipari kryesor i FjV është mungesa e një predikati foljor dhe e kategorisë së eptimit.

Përcaktorët kallëzuesorë të kryefjalës dhe një pjesë e kallëzuesve emërorë realizohen si fjali të vogla zakonisht me foljet: *bëhem, mbetem, dukem, tregohem, hiqem, gjendem apo edhe me disa folje intransitive veprorë: arrij, mbërrij, ec, lëviz, hyj, dal, fluturoj etj.*

Në fjalinë ***Vesa duket [FjV e gëzuar]*** është fjali e vogël dhe kryefjala ***Vesa*** në strukturën e thellë është kryefjalë e predikatit mbiemëror ***e gëzuar***. Kryefjala ka lëvizur nga pozicioni i predikatit mbiemëror ***e gëzuar***, ku lë një gjurmë *t* dhe ngrihet në pozicionin e kryefjalës së foljes ***duket***.

Ndërsa sa u përket pjesës tjetër të kallëzuesve që ndërtohen me foljen këpujë ***jam*** në gjuhësinë e sotme bashkëkohore ka mendime se komplementi i tyre ka strukturë të tipit të fjalive të vogla (Melvin, 2010:77). Dhe kësisoji folja këpujë trajtohet si një folje ngritëse njësoj si edhe

folja *duket*. Ndaj dhe e ashtuquajtura gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror në gramatikat tona tradicionale dhe përcaktori kallëzuesor i kryefjalës mund të trajtohen në një grup të vetëm, ndërtojnë FjV me kryefjalë një gjurmë t, e cila i referohet kryefjalës së fjalisë:

Ndërtesat<sub>i</sub> [FjV t<sub>i</sub> ishin të larta].

Në kreun e gjashtë sipas një vështrimi kronologjik kemi renditur çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e fjalive kallëzuese në gramatikat e shqipes, nga më e hershmja e deri tek ato më të fundit. Në këtë pjesë të punimit tonë fjalitë me nënrenditje i kemi klasifikuar si përbërës argumentorë dhe shtesorë. Po ashtu kemi paraqitur edhe kriteret e përcaktuara për dallimin e një fjalie se a është fjali argumentore apo është fjali shtesore. Së këndejmi, fjalitë argumentore mund t'i definojmë si fjali të subordinuara që shërbejnë si argument për predikatin e fjalisë drejtuese, kryejnë një funksion në fjali në raport me fjalinë drejtuese dhe bartin kryesisht rolin tematik të temës. Këto fjali përfaqësojnë një përmbushje të valencave të foljeve të ndryshme. Ndër llojet e fjalive argumentore bëjnë pjesë: fjalitë kryefjalore, fjalitë kundrinore, fjalitë kallëzuese dhe ato relative. Një rol thelbësor të ky lloj i fjalive luan komplementuesi, ku përfshihen mjetet lidhëse si lidhëzat e ndryshme nënrednitëse, të cilat janë kokë e sintagmës lidhëzore apo siç quhet ndryshe edhe si sintagmë komplementuese. Kjo kokë projektton një sintagmë lidhëzore, ndërsa si komplement i saj është një sintagmë eptimore (SEpt). Në klasifikimin e fjalive në fjali argumentore dhe shtesore, mund të themi që fjalitë kallëzuese zënë një vend të veçantë.

Për dallim nga llojet e tjera të fjalive, ta zëmë fjalitë kundrinore, të cilat gjenerohen në pozicionin e komplementit të sintagmës foljore, për gjenerimin e fjalive kallëzuese ka disa çështje të diskutueshme.

Por sa i përket klasifikimit të fjalive kallëzuese, ku do të duhej këto fjali, në fjali argumentore apo në fjali shtesore?

Nëse e zbatojmë kriterin e fakultativitetit, këto fjali nuk mund të kategorizohen të fjalitë shtesore, sepse janë përbërës të domosdoshëm të fjalisë. Por, nëse mbështetemi vetëm se kriteri i domosdoshmërisë, prapë nuk mund të themi se janë fjali argumentore për disa arsye, ndër to theksojmë:

- nuk janë fjali argumentore, sepse nuk shërbejnë si argument i predikatisë drejtuese;
- folja *jam* është folje njëvalente dhe si argument të jashëm e ka vetëm kryefjalën;

- folja *jam* nuk cakton rol tematitik.
- në teoritë bashkëkohore sintaksore fjalitë e subordinuara janë sintagma, projeksione të kokës funksionale që në këtë rast mund të jetë lidhëza ose siç mund ta hasim në literaturë me termin komplementuesi dhe eptimi.

Fjalja e subordinuar mund të trajtohet si sintagmë lidhëzore ose si sintagmë komplementuese në rastet kur lidhëza është e shprehur dhe kur ajo s'është e shprehur fonetikisht, po që mund të vendoset në fjali pa ia prishur kuptimin fjalisë. Pjesë përbërëse e këtij kreu është edhe analiza sasiore e fjalive kallëzuesore duke u bazuar në korpusin tonë të zgjedhur.

Duhet theksuar se qëllimi ynë në këtë punim s'është që të përsëriten trajtimet e bëra gjer tani në gramatikat e shqipes për fjalitë kallëzuesore, por disa çështje të diskutueshme të përpiqemi t'i trajtojmë në një rrafsh tjetër sipas qasjes së teorive të sotme sintaksore, në mënyrë që të japim shpjegimet e nevojshme rreth mekanizmit të gjenerimit të fjalive kallëzuesore në gjuhën shqipe. Madje shpeshherë është vënë në diskutim ekzistenca e këtyre fjalive se a ekzistojnë në të vërtetë apo jo për shkak të foljes këpujë në fjalinë drejtuese, e cila nuk mund të caktojë rol tematik.

Në kreun e shtatë kemi trajtuar fjalitë e vogla, të cilat kanë qenë temë diskutimi në mesin e gjuhëtarëve të huaj dhe iu kanë kushtuar vëmendje të veçantë këtij tipi fjalish. Në shumë studime, kryesisht në literaturë e huaj, për termin *fjali e vogël* përdoret termi *klauzë e vogël*. Një term tjetër tradicional që përdoret për këto fjali është termi *predikat dytësor*.

Termi fjali e vogël përdoret kryesisht në tipin e fjalisë me strukturë: SE1 SF SE2 SX, ku SE2 SX janë përbërës dhe ekziston një marrëdhënie predikative midis tyre dhe në përbërësin SX në vend të një folje të shtjelluar paraqitet një SE, SM apo një SP. Për herë parë konceptin fjali të vogël e përdori gjuhëtari E. Williams më vitin 1975. Në studimet sintaksore përgjithësisht pranohet që fjalitë e vogla nuk e kanë nyjen Ept, rrjedhimisht në paraqitjen e tyre strukturore këto fjali nuk janë sintagma eptimore (SEpt).

Ekzistenca e tyre mbështetet kur aplikohen teste të ndryshme (Aarts, 1992:36-49). Më poshtë japim pesë lloje testesh, të cilat përdoren në literaturë gjuhësore dhe argumentojnë ekzistencën e fjalive të vogla si përbërës: (1) testi i koordinimit, (2) përdorimi i pavarur i vargut [SE2 SX], (3) vargu predikativ [SE2 SX] si subjekt, (4) modifikimi adverbial i vargut predikativ [SE2 SX] dhe (5) emrat e prejardhur.

Sipas këndvështrimit gjenerativ ekzistojnë dy qasje të trajtimit fjalive të vogla: njëra qasje është trajtimi i këtyre fjalive si pjesë e një kategorie funksionale dhe qasja tjetër është si projeksion i një kategorie leksikore. N. Chomsky (1981, 1986) dhe T. Stowell (1983) e konsiderojnë fjalinë e vogël si përbërës të veçantë, por s'pajtohen rreth statusit të saj kategorial.

Stowell thekson se FjV do të shihej vetëm një propozicion, kurse folja që e përzgjedh atë do të ishte “verbër” ndaj strukturës së saj të brendshme, qoftë semantikisht apo sintaksisht. Sipas qasjes së re, propozohet që funksionin e subjektit e kryen SE si specifikues i fjalisë së vogël. Rrjedhimisht, SE në vargun [SE SX] është subjekt i sintagmës SX, FjV bëhet njësi minimale funksionale brenda së cilës zbatohen rregullat e lidhjes. Statusi kategorial i FjV-së përcaktohet nga koka e fjalisë së vogël, e cila mund të jetë SE, SM dhe SP.

Stowell fjalitë e vogla i ndan FjV në dy lloje: në FjV në rolin e adjunktit dhe të komplementit dhe njëherit për këtë lloj ndarje propozon dy zgjidhje sintaksore. Për FjV në rolin e komplementit thekson se folja e shtjelluar e drejton fjalinë e vogël dhe i cakton rasë subjektit sipas rregullave të c-komandës. Ndërsa predikati dytësor me kuptim deskriptiv, i cili e modifikon subjektin dhe kundrinën, sipas Stowell-it, janë fjali të vogla në rolin e adjunktit dhe nuk formohen brenda SF-së, që për pasojë pozicioni i subjektit të FjV-së nuk është kryefjalë që drejton dhe në këtë pozicion mund të vendoset elementi PRO. Pra, Stowell zgjidhjen që e paraqet për këto struktura është i ashtuquajturë mekanizmi të kontrollit të subjektit dhe i kontrollit të kundrinës. E ilustruam me shembujt e marrë nga T. Stowell:


(a) Billi [VP endej në shtëpi] [SM PRO i dehur].

(b) Xhoni [SF e ngarkoi sanën në karrocën] [SMb PRO jeshile].

A. Kananaj (2012:148) i përkufizon fjalitë e vogla si njësi predikative minimale, sintaksorisht si një segment SX SY, elementet e të cilit hyjnë në një marrëdhënie predikative pa ndërmjetësinë e ndonjë kategorie funksionale, veçse predikati SY nuk përmban një sintagmë foljore (SF), por një SE, SMb, SP etj., p.sh.: *Unë e konsideroj [atë inteligjent].*

Përbërësit në kllapa katrore formojnë një FjV, e cila shërben si komplementi i foljes *konsideroj* dhe marrëdhëniet që krijohen në fjali skematikisht mund të shprehen në këtë mënyrë:





Në kuadër të korpusit tonë, në fund të këtij kreu, do të japim një analizë sasiore të fjalive të vogla në rolin e komplementit dhe të adjunktit.

Dhe në pjesën e fundit të punimit i kemi dhënë përfundimet e nxjerra në lidhje me çështjet e trajtuara për fjalitë kallëzuesore në gjuhën shqipe. Punimi mbyllet me dhënien e bibliografisë ku jemi mbështetur për trajtimin e këtij studimi.

## Summary

The structure of our doctoral dissertation “Predicative clauses in Albanian language” consists of seven chapters. This research paper is divided into chapters and subchapters.

In the first chapter, we have presented the concepts of several syntactic units, such: phrases, sentences, complex sentences, coordinate clause and subordinate clauses. For the construction of a phrase, one or more words are used that are related to each other based on clearly defined rules. There are several tests that prove whether a sequence of words forms a phrase. The presence of components can be proven by applying criteria for distinguishing the components, such: substitution test, displacement or movement test, coordination test and fragment test.

The second chapter continues with the treatment of some issues related to the classification criteria of subordinate clauses. In order to classify this unit in the Albanian language, we have taken the traditional grammars of Albanian in chronological form, starting from the earliest to today's grammars of Albanian as treated in their recent studies by Albanian researchers, who have a different approach regarding the criteria for classifying subordinate clauses in the Albanian language.

In the third chapter we have treated the classification of verbs according to function and meaning, namely focusing on the traditional classification of verbs, then the issue of transitivity and ergativity of Albanian verbs. In this paper we have dealt extensively with the treatment of

valency, the argument structure of the verb and the thematic roles that the arguments can have in one clause or as it is otherwise known as  $\theta$ -theory.

In the fourth chapter we have treated copular verbs and copular clauses in Albanian language. Generally, their classification is based on their lexical meaning and for their chronological analysis we have taken the Albanian grammars. The researchers who have dealt with the examination and analysis of short sentences are: F.R. Higgins (1973), L. Heggie (1988), L. Mikkelsen (2005), C. Heycock (1997), M. Haliday, A. Moro (1997), R. Huddleston (2002), B. Russell, S. Rothstein (1995) et al. Among the first researchers to take up the question of classifying clauses is Higgins, who analyzes clauses according to a taxonomy called taxonomy of copular clauses. Copular clauses are classified into predicational clauses, specificational clauses and identification clauses. A series of transformational rules operate in copular clauses, which then make it possible to move the clauses from the surface structure to the deep structure. Consequently, all types of these clauses are surface structures and have only one deep structure.

During the process of changing the positions of the components in the clause, there are obtained grammatically correct clauses, as follows:

(a) Teuta is a doctor. (predicational clause)

(b) The doctor is Teuta. (specificational clause)

In example (a) which is a predicational clause, the predicative complement is expressed by a singular noun, which can be moved to the position of the subject [Spec] of the specificational clause. In this type of classification, the concept of referentiality is important, which is about the relation between the object or subject and of the phrase or clause that we refer to.

In the end, after reviewing and analyzing the clauses in the Albanian language, the frequency of their use is given in our selected corpus.

In the fifth chapter, we have dealt with some theoretical issues of the treatment of the nominal predicate and the predicative complement in Albanian. In modern theoretical approaches, the so-called nominal predicate in our tradition is analyzed within the clause through the relation subject-copular verb-predicative complement, thus building a copular clause. There are researchers who recognize the construction of the so-called nominal predicate, while some others think that the element after the copula forms a special grammatical category, it forms the

predicative complement. In this paper we have given a different perspective and we will talk about a new type of clauses: small clauses.

Our study aims to treat the nominal predicate and predicative complement, as two entities with the same semantic and structural features, in a single syntactic category. Such a syntactic category can not be considered anymore as a traditional part of sentence but rather as a special type of clause, specifically as a small clause. It should be noted that not all nominal predicates can be included in this syntactic category. It is noted that there are no differences between a subject predicative complement and most types of nominal predicate, but that there are structural differences between these two categories and the subject predicative complement. It should also be affirmed that the differences between them are not so great as to justify their division into separate categories.

In the Albanian language, the category of predicative complement consists of two types of small clauses:

- 1) Object predicative complement: small clauses as complements of the verb
- 2) Subject predicative complement and nominal predicates: small clauses with raising verbs.

SC (small clauses) that are realized as complements of the verb are found in constructions of the type: *I found [SC the door open]*.

The components *the door open* form a minimal predicative structure: a small clause, with a subject-predicate structure, where the subject is in the accusative case and the predicate is expressed with an adjective. According to this analysis, all object predicative complement in the Albanian language can be seen as predicates of SC that are the complement of the verb.

Or the clause: *I saw [Petrit tired]* according to researcher L. Buxheli, the component in brackets is a small clause. One other example of a clause that, according to her is also SC, but we think that this is not SC, as:

I saw Petrit [writing [tiredly]]. (Buxheli, 2007:91)

We think that this clause has a predicate expressed by a verb and as such cannot enter the group of small clauses because was said before, the main feature of SC is the absence of a verbal predicate and the category of infection.

Subject predicative complement and one part of the nominal predicates are realized as small clauses usually with the verbs: *become, remain, appear, show, remove, find* or even with some *intransitive verbs: reach, arrive, walk, move, enter, exit, fly* etc.

In the clause: *Vesa seems [sc happy]* is the small clause and the subject *Vesa* in the deep structure is the subject of the adjectival predicate *happy*. The subject has moved from the position of the adjectival predicate *happy*, where it leaves a trace of *t*, and rises to the position of the subject of the verb *seems*.

As for the rest of the predicates that are built with the verb *to be*, in today's contemporary linguistics there are opinions that their complement has the structure of the type of small clauses (Melvin, 2010:77). And so the copular verb is treated as a rising verb just like the verb *seems (duket)*. Therefore, the so-called noun part of the nominal predicate in our traditional grammars and the subject predicative complement can be treated in a single group, build SC with the subject a trace *t*, which refers to the subject of the clause:

Buildings [<sub>SC</sub> <sub>ti</sub> were high].

In the sixth chapter, according to a chronological view, we listed the issues related to the treatment of predicative clauses in Albanian grammars, from the earliest versions of it to the most recent one. In this part of our work, we have classified clauses with subordination as argument and adjunct components. We have also presented the criteria defined for distinguishing a clause whether it is an argument clause or an adjunct clause. Thus, the argument clauses can be defined as subordinate clauses that serve as an argument for the predicate of the leading clause, perform a function in the clause in relation to the leading sentence and mainly carry the thematic role of the topic.

These clauses represent a fulfillment of the valences of different verbs. Among the types of argumentative sentences are: subject clauses, object clauses, predicative clauses and relative clauses. An essential role in this type of clauses is played by the complementizer, which includes various subordinators, which are the head of the phrase or as it is otherwise called the complement clause. This head projects a complement clause, while its complement is an inflectional phrase (IP). In the classification of clauses into argument clauses and adjunct clauses, we can say that predicative clauses occupy a special place.

Unlike other types of clauses, there are some controversial issues for the generation of predicative clauses.

But as for the classification of predicative clauses, where should these clauses be placed, in argument clauses or in adjunct clauses?

If we apply the criterion of optionality, these clauses cannot be categorized as adjunct clauses, because they are necessary components of the clause. But, if we rely only on the criterion of necessity, we still cannot say that they are argument clauses for several reasons, among them we emphasize:

- they aren't argument clauses, because they don't serve as an argument of the predicate of the main clause;
- the verb to be (*shqip: jam*) is a monovalent verb and has only the subject as an external argument;
- the verb to be (*shqip:jam*) does't assign a thematic role.
- in modern syntactic theories, subordinate clauses are phrases, projections of the functional head, which in this case can be a subordinator or as we can find in the linguistics, with the term complementizer and inflection.

The subordinate clause can be treated as a complementary phrase in cases where the subordinator is expressed and when it is not expressed phonetically, but it can be placed in the clause without spoiling the meaning of the clauses. An integral part of this chapter is the quantitative analysis of predicative clauses based on our corpus.

It should be emphasized that our goal in this paper is't to repeat the treatments done so far in Albanian grammars for predicative clauses, but to try to treat some controversial issues on a different level than the approach of today's syntactic theories, in order to give the necessary explanations about the mechanism of generating predicative clauses in the Albanian language. Even the existence of these clauses has often been questioned as to whether they actually exist or not because the copular verb in the main clause, which cannot assign a thematic role.

In the seventh chapter we have analyzed small clauses, which have been the subject of discussion among foreign linguists of different language schools and have paid special attention to these types of clauses. Another traditional term used for these clauses is the term secondary predicate.

The term small clause is mainly used in the type of clause with the structure: NP1 VP NP2 XP, where XP2 XP are components and there is a predicative relation between them and in the SX component instead of an elaborate verb an NP, AP or an PP appears. For the first time the concept of a small clause was used by the linguist E. Williams in 1975. In syntactic studies, it is generally accepted that small clauses don't have the node IP, therefore in their structural presentation these clauses are not inflectional phrases (IP).

Their existence is supported when various tests are applied (Aarts, 1992:36-49). Below we give five types of tests, which are used in the linguistic literature and argue for the existence of small clauses as constituents: (1) the coordination test, (2) the independent use of the string [SE2 SX], (3) the predicative string [SE2 SX] as subject, (4) adverbial modification of predicative string [SE2 SX] and (5) derived nouns.

According to the generative point of view, there are two approaches to treating small clauses: one approach is to treat these clauses as part of a functional category and the other approach is as a projection of a lexical category. N. Chomsky (1981, 1986) and T. Stowell (1983) consider that the small clause as a separate component, but disagree about its categorial status.

Stowell points out that SC would only be seen as a proposition, while the verb selecting it would be "blind" to its internal structure, whether semantically or syntactically. According to the new approach, it is proposed that the subject function is performed by NP as a small clause specifier. Consequently, the NP in the string [NP XP] is the subject of the XP syntax, SC becomes the minimal functional unit within which the concatenation rules apply. The categorial status of SC is determined by the head of the small clause, which can be NP, AP and PP.

Stowell divides small clauses into two types: SC in the role of adjunct and complement and at the same time proposes two syntactic solutions for this type of division. For SC in the role of complement, it emphasizes that the elaborated verb directs the small clause and assigns case to the subject according to the rules of the c-command. While the secondary predicate with a descriptive meaning, which modifies the subject and the object, according to Stowell, they are small clauses in the role of adjunct and are not formed within the VP, as a result the subject position of the SC isn't the subject that leads and in this position the PRO element can be placed. So, the solution that Stowell presents for these structures is the so-called mechanism of control of the subject and control of the opposition. We illustrate it with examples taken from T. Stowell:

(a) Billy [<sub>VP</sub> wandering home] [<sub>AP PRO</sub> drunk].


(b) Johnny [<sub>VP</sub> loaded the hay into the cart] [<sub>AP PRO</sub> green].

In Albanian grammars we don't find treatments for small clauses, apart from recent special researches made by researchers who deal with syntactic studies. One of them is the researcher A. Kananaj, who in the monography *Circumstances in Albanian* (2015) in addition to the treatment of the circumstantial, also deals with the structure of these clauses.

Kananaj (2012:148) defines SC as minimal predicative units, syntactically as a segment XP YP, whose elements enter into a predicative relation without the mediation of any functional category, but the predicate YP doesn't contain a verb phrase (VP) , but an NP, AP, PP etc., for example:

I consider [him intelligent].

The components in square brackets form a SC, which serves as the complement of the verb *consider*, and the relations that are created in the clause can be schematically expressed in this way:



And in the last part of the paper, we have given the conclusions drawn in relation to the issues addressed for predicate sentences in the Albanian language. The paper closes with the bibliography that we have relied on for the treatment of this study.